



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 27 korrik 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Muhamet Mustafa.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Agron Tigani KUR Hidrodrini

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës)- Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i pasqyrave të audituara financiare të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010.
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të KUR Hidrodrinit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në bazë të nenit 64 të Rregullores së Kuvendit shqyrtimi i pikës një të rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

Rendi i ditës u miratua me propozimin e kryetarit të Komisionit.

2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të KUR Hidrodrinit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010

Kryetari - ZAP – Ka dhënë opinion të kualifikuar lidhur me pasqyrat financiare të KUR Hidrodrinit. Kjo kompani ka planifikim jo të mirë të shpenzimeve. Ka rritje të shpenzimeve për vitin fiskal për vitin 2010 krahasuar me vitin 2009 për 100mijë euro, rritja e borxheve, regjistrimi – nuk ka prezantuar stoqet, humbje të ujit ka 72%, ka planifikuar se do të realizoj të hyra 60%, dosja e personeli ka vërejtje, një rekrutim pa konkurs dhe ka vërejtje se auditori i brendshëm ka bërë disa auditime, por nuk ka gjetur përkrahje në Bord. Bordi është i përbërë edhe nga një anëtarë i emëruar nga Qeveria dhe po ashtu ka pozitë menaxheriale. Kjo është në kundërshtim me ligjin.

Agron Tigani – Performanca vlerësohet nga Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJMNP) dhe Zyra Rregullative. Kur Hidrodrini ka hartuar një plan strategjik afatgjatë për të reduktuar humbjet e ujit. Në këtë strategji duhen investime deri në 6 milion euro. Ka 24 orë ujë dhe kur ka 24 orë ujë edhe humbjet janë të mëdha.

Arsim Maloku – Ngritja e shpenzimeve – kompania nuk ka pasur auditor të brendshëm dhe ka punësuar një auditor të brendshëm. Politikat e kompanisë për pagesën e inkasantëve janë si rezultat i inkasimit dhe si rezultat i kësaj inkasantët janë paguar më tepër. Beneficionet për efektshmëri që i ka marrë Bordi i Drejtorëve në vitin 2009 menaxhmenti nuk ka mundur t'i planifikoj. Bordi ka marrë 11 paga si beneficion për performancë. Rritja e detyrimeve – në rend të parë rritja e detyrimit ndaj TVSH-së. Kompania ka një marrëveshje të mirëkuptimit me Ministrinë e Financave që TVSH-ja të paguhet në inkasim dhe pjesa tjetër mbetet që të figuroj si detyrim në librat e kontabilitetit të kompanisë. Rritje tjetër që kanë pas ndikim janë të hyrat e shtyra si detyrim. Donacioni mbi 1 milion euro është regjistruar si aset i kompanisë por në “sikunderkonto” si detyrim i shtyrë që në ndërkohë vjen duke u shlyer si detyrim i shtyrë. Mos prezantimi i stoqeve - kur është bërë korporatizimi i ndërmarrjes në vitin 2007, vlerësimi i stoqeve dhe aseteve është bërë nga një kompani e huaj e cila ka ardhur në përfundim se stoqet të cilat disponon kompania janë të mbivlerësuara, por ka edhe të nënvlerësuara. Meqenëse nuk ka bërë një vlerësim të stoqeve por një rivlerësim të aseteve fikse ka mbet që me daljen e një kompanie të specializuar për vlerësimin e stoqeve dhe aseteve të kontraktohet për këtë vlerësim. Ajo kompani ka vlerësuar stoqet që ekzistojnë nëpër depot e kompanisë - Vlera reale e tyre është e prezantuar, por në bilancin e gjendjes prezantohet edhe korrigjimi i atyre stoqeve, deri në vlerësimin real të një kompanie të specializuar e që për momentin nuk ekziston në Kosovë. Vërejtjet e auditorit të brendshëm – ka has në parregullsi mirëpo menaxhmenti ka adresuar këto vërejtje, por disa prej tyre duhet një kohë për implementim. Është e vërtetë që një anëtarë i Bordit është edhe drejtor i një kompanie – menaxhmenti një viti nuk i ka bërë pagesën këtij anëtari të Bordit, por Gjykata ka vendosur që anëtari i Bordit nuk ka bërë shkelje të ligjit dhe menaxhmenti është detyruar të bëjë pagesën për një vit - mëditje. Ligji lejon beneficionet nëse kanë performancë të mirë, dhe lidhur me këtë bordi ka marrë vendim. NJMNP është njoftuar për vendimin e Bordit dhe të kjo njësi ka të gjitha raportet mujore dhe tremujore. Bordi do të marrë përsëri vendim për paga për vitin 2010.

Armend Zemaj – Pyeti: në bazë të cilit ligj anëtarët e Bordit janë paguar me njëmbëdhjetë rroga shtesë plus një rrogë të dymbëdhjetë?

Agron Tigani – KUR Hidrodrini është vlerësuar si kompania më e mirë dhe si rezultat i kësaj bordi ka marrë beneficionin prej 11 pagash. Bordi e ka pritur performancën prej NJMNP dhe Zyres Rregullative dhe në bazë të kësaj ka marrë këtë vendim.

Valbon Bytyqi - ZAP-i ka dorëzuar raportin në të cilin humbjet e ujit janë ndërmarrjet e ujësjellësit dhe ujitjes, mirëpo në këtë kompani ka pas më shumë. Pasuritë të cilat janë prezantuar si pasuri të kompanisë e të cilat realisht kanë qenë pronësi private dmth nuk janë

pasuri të Kompanisë. Kjo është ana materiale që ka bërë që raporti të jetë i kualifikuar si dhe stoqet të cilat nuk janë ekzaminuar në gjendjen.

Ramiz Lladrovci – Humbjet administrative a nënkuptojnë humbjet në pagat e Bordit apo diçka tjetër? Auditori i brendshëm a është pranuar me konkurs dhe a ka kualifikim personi që është pranuar për këtë punë? Bordi - sa anëtarë ka dhe sa është kostoja për efektshmëri? Kryeshefi a është i detyruar që të zbatojë vendimet e Bordit edhe nëse ato janë në kundërshtim me ligjin? A jeni të detyruar të bëni pagesa të jashtëligjshme? Merren rroga për efektshmëri me gjithë këto keqpërdorime? Vendimi i Gjykatës është ekzekutuar- a keni bërë ankesë në instancë më të lartë apo keni paguar menjëherë? Mallrat e pranura jashtë kushteve të kontratës- janë pranuar mallra jashtë specifikacionit të kontratës, kjo është e ndaluar me ligj.

Bali Muharremaj – Sa ka arritur kompania të rrisë inkasimin që nga momenti që ka marrë këtë pozitë drejtori dhe kryeshefi?. Donacioni në vlerën prej 1 milion e 200 mijë euro a është donacion i vitit të fundit apo po përsëritet nga vitet e kaluara dhe inkasimi a bëhet paushall apo me orëmatës?

Mursel Haljilji – Humbjet janë alarmante në inkasim, sepse humbjet paraqiten te pagesat, pastaj te kërkesat. Shumë shtëpi nuk kanë orëmatës. Sa i ngarkoni ato familje dhe te ata të cilët nuk paguajnë a keni ndërmarrë masa të vërejtjeve dhe a jeni angazhuar që t'i qkëqni nga rrjeti?

Armend Zemaj – Shpenzimet për efikasitet janë për keqardhje, sepse një Bord me të gjitha këto keqpërdorime të paguhet për efektshmëri- është për keqardhje. Çështja e prokurimit - ka të gjetura, mos prezantimi i stoqeve dhe pasurisë të lenë dyshime për keqpërdorime dhe e tërë kjo bie mbi supet të taksapaguesve. Duhet kërkuar përgjigje edhe nga Ministria e Financave se si janë toleruar këto pagesa. Komisioni duhet të ftojë në një takim udhëheqësin e NJMNP, në mënyrë që pastaj të nxjerr një rekomandim për Kuvendin.

Agron Tigani – Ligji për Ndërmarrjet Publike nuk është i mirë. Ka një nen për stimulime në bazë të të cilit Bordi ka marrë beneficionet për efektshmëri. Instalimi i orëmatësve – është e vetmja kompani që në vitin 2010 që ujin e faturuar 87% e ka inkasim me ujëmatës. Çdo muaj ka rritje të konsumatorëve dhe kompania duhet çdo muaj të blejë ujëmatës dhe dihen procedurat e prokurimit.

Rasim Maloku – Mos prezantimi i stoqeve të blera në vitin 2010, kjo është mangësi e softuerit që nuk e jep vjetërsinë e stoqeve, dhe jemi në negociata për ndërrim të softuerit. Ujëmatësit e vendosur në burime i lexojmë ditën e fundit të muajit dhe mbi 30 mijë ujëmatës nevojitet një muaj. Kjo është humbja administrative, sepse leximet nuk bëhen me kohë. Konkursi për auditor të brendshëm tri herë. Auditori i brendshëm është auditor i licencuar. Bordi ka katër anëtarë dhe kryeshefi ekzekutiv pestë nuk ka marrë rrogë për performancë. Donacionet janë aprovuara para tri viteve janë donacion gjerman. Faturimi me ujëmatës bëhet 87%. Rritja e shpenzimeve – uji i prodhuar kemi obligim prej 0.001 cent vlerë ujore, Ministrisë për Planifikim Hapësinor. Obligim ndaj kësaj ministrie deri tani janë paguar, por kemi 30 mijë euro. Shkeljet në prokurim - janë të vërteta gjetjet. Kualiteti i naftës kompania ka qenë këmbëngulëse që OE të bijë certifikatë të kualitetit. Nuk ka konkurruar asnjë kompani sepse nuk kanë pasur certifikatë dhe nevoja për furnizim ka qenë urgjente. Rasti i mbështjelljes së pompave-është parë se është dëmtuar edhe kushineta dhe në këtë rast është vendosur që i njëjti operator të vendosë edhe kushinetat, sepse rreziku i dëmtimit ka qenë i madh. Këtë vit i njëjti operator konkurren edhe për vendosjen e kushinetave. Menaxhmenti kur është bërë shkelja e ligjit njofton NJMNP dhe për rastet e diskutuara në këtë mbledhje ata janë të njoftuar.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJ

1. Kompania e Ujësjiellësit Rajonal “Hidrodrini”, të ndërmarrë masa konkrete për rritjen e efikasitetit të proceseve menaxheriale dhe të kontrollit të brendshëm.
2. Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu kryetar i Komisionit.

Të Ndryshme

Komisioni vazhdoi punimet jashtë ndërtesës së Kuvendit në pajtim me vendimin e Komisionit të datës 26 Korrik 2011.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Ali Sadriu